

HAP PAS HAPI

Trajnimi fillestar për edukatorë që punojnë
me fëmijë të moshave 3-6 vjeç

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e *koncepteve të përgjithshme filozofike* dhe bazën teorike të *programit me në qendër fëmijën*
- Njohjen e *praktikave të përshtatshme zhvillimore* që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale
- Aftësi për organizimin e *mësimit të individualizuar*, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë *frymën demokratike në klasë*
- Aftësi për *organizimin e mësimit kooperativ* që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm
- Aftësi për *planifikimin e mësimit tematik* me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies
- Shkathtësi për *vëzhgimin e fëmijës dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë*
- Aftësi për *aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies* në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore
- Ide për krijimin e një *ambienti stimulus për mësimnxënie aktive*

- Njohuri për *përfshirjen e familjes* në realizimin e programit

Përmbajtja e trajnimit fillestar për klasën e parë

Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm i metodologjisë me në qendër fëmijën, individualizimi, rregullimi i klasës me në qendër fëmijën, materialet në klasë, të mësuarit përmes lojës, roli i edukatorit në klasë me fëmijën në qendër, planifikimi global, planifikimi mujor-javor, planifikimi ditor, dita e balancuar, takimi i mëngjesit, vëzhgimi, dokumentimi, vlerësimi, puna ekipore, përfshirja e familjes, përdorimi i materialeve recikluese, qendrat e aktiviteteve (matematika, blloqet, shkenca, lexim- shkrimi, arti figuratov, familja-dramatizimi, rëra dhe uji).

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet edukatorëve të cilët punojnë me fëmijë të moshave 3-6, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi fillestar për edukatorë realizohet me anë të një trajnimi 5 ditorë që përfshin gjithsej 40 orë. Ky trajnim pasohet me 4 punëtori një ditore gjatë një viti akademik.

Me qëllim që të përcillet puna në kontinuitet dhe të punohet sa më shumë në cilesi të punës çdo muaj parashihen monitorime në klasë.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnime.